

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË AFARIZMIT TË SHPEDITERËVE NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS

Bazuar në Nenin 4 pika 2 dhe Nenin 6 pika 2 të Statutit të Shoqatës së Shpeditereve të Brendshëm dhe Ndërkombëtar të Kosovës, pas miratimit të Draft punimit nga ana e anëtarëve të Shoqatës, Këshilli Drejtues i Shoqates së Shpeditereve të Brendshëm dhe Ndërkombëtar të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 30.01.2012, miraton:

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË AFARIZMIT TË SHPEDITERËVE NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS

I. VLEFSHMËRIA E KUSHTEVE

Neni 1.

Këto kushte të përgjithshme vlejné për të gjitha punët e shpedicionit.

Do të konsiderohet se palët kontraktuese, kanë arritur marrëveshje për përdorim të kushteve të përgjithshme, nëse shpediteri, me shkrim e ka njoftuar urdhërdhënësin e tij, se afarizmi i tij bazohet në këto kushte, kurse urdhërdhënësi nuk i ka përjashtuar në mënyrë eksplicite dhe me shkrim, aplikimin e tyre.

Neni 2.

Shpediteri është organizator i dërgimit apo sjelljes së gjëseneve (mallërave), me të gjitha llojet e mjeteve transportuese nëpërmes të të gjitha rrugëve transportuese. Me kontratën mbi shpeditimin, shpediteri obligohet që, për qëllim të transportimit të gjëseneve të caktuara, në emër të vet dhe për llogari të urdhërdhënësit, në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit respektivisht në emër të vet dhe për llogari të vet, të lidhë kontratë mbi transportin dhe kontrata të tjera të nevojshme për realizimin e transportit, si dhe kryen punë dhe veprime të tjera të zakonshme, kurse urdhërdhënësi obligohet që t'i paguajë kompenzim të caktuar.

Punët shpeditere veçanërisht janë:

-dhënja e këshillave profesionale dhe pjesëmarrja në bisedimet shitblerëse me qëllim të përmbylljes së kontratës mbi shitjen ndërkombëtare, nga aspekti i transportit, sigurimit, manipulimeve doganore etj;

-gjetja e rrugëve dhe klauzoleve më të lëvërdishme transportuese të cilat duhet të përdoren në shitjen dhe transportin ndërkombëtar të gjësendeve, me qëllim të mbrojtjes së interesit të urdhërdhënësit;

-sigurimi i privilegjeve, refakcioneve (koncesioneve) dhe kushteve të tjera më të favorshme, nga ana e transportuesve të brendshëm apo të jashtëm dhe nga pjesëmarrësit e tjerë;

-organizimi i transportit përmbledhës;

-organizimi i transportit multimodal dhe integral të gjësendeve si dhe distribuimi fizik i gjësendeve me anë të sistemit “prej derës në derë”;

-lidhja e kontratës mbi transportin në të gjitha llojet e transportit;

-lidhja e kontratës mbi ngarkimin, shkarkimin, ringarkimin, sortimin, paketimin, respektivisht kryerjen e këtyre apo punëve të tilla të ngjajshme;

-lidhja e kontratës mbi magazinimin e gjësendeve respektivisht magazinimi i gjësendeve;

-lidhja e kontratës mbi sigurimin e gjësendeve;

-përfaqësim dhe kryerje e punëve që lidhen me doganimin e gjësendeve (përfaqësim doganor);

-marrja e mostrave, konstatimi i sasisë së gjësendeve pa lëshuar çertifikatë;

-pjesëmarrje në arkëtimin e kërkesave me rastin e dorëzimit të gjësendeve;

-lëshimi i vërtetimeve shpeditere si instrument pagese në qarkullimin e jashtëm tregtar të gjësendeve, si dhe lëshimi i FIATA dokumenteve të tjera;

-sigurimi apo plotësimi i dokumenteve transportuese dhe të tjera;

-kontrolla e saktësisë kalkuluese të dokumenteve transportuese si dhe kalkulimi i shpenzimeve transportuese dhe shpenzimeve të tjera;

-marrja e masave për zhdëmtim, në rastet e humbjes, dëmtimit apo vonesës në dorëzim të gjësendeve;

-sigurimi i lejeve tranzitore dhe dokumenteve të tjera;

- organizimi i akull-shtimit, si dhe sigurimi i ushqimit dhe ujit për kafshë të gjalla;
- kryerja e shërbimeve në panairë nderkombetare, ekspozita speciale dhe të pavarura si dhe evenimente të ngjajshme në vend dhe jashtë vendit;
- shpedicioni i brendshëm
- punë të tjera të cilat janë të zakonshme në afarizmin e shpedicionit ndërkombëtar;

II. OFERTA

Neni 3.

Oferta e shpediterit përfshin vetëm punët të cilat janë të paraqitura në mënyrë të qartë (eksplicite) në të;

Neni 4.

Oferta vlenë vetëm deri në skadimin e afatit të caktuar në të për pranimin e saj;

Neni 5.

Oferta në formë të një shume gjithëpërmbledhëse (pozicion forfait i kompletuar për të gjitha fazat e shpeditimit, respektivisht transportit) e cila, ndër të tjera, përmban shpenzimet transportuese, shpenzimet e përfaqësimit doganor, shpenzime të magazinimit apo të ngjajshme, vlenë sipas rrethanave të cilat ekzistojnë në momentin kur oferta është bërë.

Shpenzimet të cilat nuk janë të përfshira në pozicionet forfait, urdhërdhënësi do t'ia kompenzojë ndaras shpediterit.

Urdhërdhënësi nuk ka të drejtë t'i bartë forfait pozicionet e pranuar te personi i tretë pa miratimin paraprak të shpediterit.

III. URDHËRPOROSIA (DISPOZITA)

Neni 6.

Dërgimin apo sjelljen (transportimin, bartjen) e gjësendeve, si dhe punët në lidhje me dërgimin e gjësendeve, shpediteri i kryen në bazë të urdhërporosisë (dispozitës) së dhënë nga urdhërdhënësi.

Urdhërporosia (dispozita) përmban të gjitha të dhënat e nevojshme mbi gjësendet dhe karakteristikat e tyre, udhëzime të sakta mbi dërgimin e tyre dhe për kryerjen e punëve që lidhen me dërgimin (transportimin, bartjen), por gjithashtu edhe të dhëna të tjera të cilat janë të nevojshme për kryerje të rregulltë dhe me kohë të urdhërporosisë së dhënë.

Neni 7.

Urdhërdhënësi është i obliguar t'a njoftojë shpediterin mbi veçoritë e gjësendeve, veçori të cilat mund t'a rrezikojnë sigurinë e personave, të të mirave apo të shkaktojnë dëm.

Kur në dërgesë gjinden gjësende të çmuara, letra me vlerë apo gjësende të tjera të çmuara, urdhërdhënësi është i obliguar që t'a njoftojë për këtë shpediterin dhe t'a informojë mbi vlerën e tyre në momentin e dorëzimit të gjësendeve për dërgim (transportim).

Neni 8.

Shpediteri është i obliguar që t'i përmbahet (ta respektojë) dispozitës së urdhërdhënësit.

Urdhërdhënësi është i obliguar që t'a njoftojë shpediterin në rast se i bartë të drejtat e veta nga kontrata mbi shpeditimin te personi i tretë. Shpediteri është përgjegjës para personit të tretë, në kufijtë e obligimeve të veta ndaj urdhërdhënësit, nëse nuk është kontraktuar ndryshe.

Neni 9.

Kur shpediteri i është dhënë dispozita, konsiderohet se i është dhënë autorizimi për pagesë të transportit, taksave dhe shpenzimeve të tjera.

Urdhërdhënësi, në kohë të duhur, do t'i vë në dispozicion të shpeditarit, mjetet e nevojshme për mbulim të shpenzimeve, sipas paragrafit të parë të këtij neni; në të kundërtën do t'i bartë pasojat.

Nëse urdhërdhënësi e udhëzon shpeditarin që për mjetet sipas paragrafit të dytë të këtij neni, t'i drejtohet partnerit afarist të urdhërdhënësit, urdhërdhënësi është i obliguar që për këtë paraprakisht t'a njoftojë partnerin afarist. Në këto raste, shpediteri i kryen pagesat për

llogari dhe rrezik të urdhërdhënësit, në mënyrë që urdhërdhënësi mbetet obligues ndaj shpeditërit nëse për arsye që janë jashtë mundësive të tij, nuk arrin që t'i arkëtojë shpenzimet nga partneri afarist.

Neni 10.

Urdhërporosia (dispozita) sipas rregullit jepet me shkrim. Urdhërporosia e dhënë me gojë, nëpërmes telefonit, telegramit ose teleteksit, sipas rregullit duhet të confirmohet me shkrim, mundësisht të njëjtën ditë apo më së largu ditën e ardhshme të punës.

Nëse urdhërporosia është dhënë me gojë, nëpërmes telefonit, teleksit apo telegramit, kurse më vonë nuk është confirmuar sipas pikës paraprake, shpeditëri nuk është përgjegjës për pasojat eventuale.

Kur shifet qartë se urdhërporosia është jo e plotë, e paqartë apo kundërthënëse, shpeditëri është i obliguar që me kohë të kërkojë nga urdhërdhënësi sqarimet e nevojshme.

Nëse, bazuar në rrethanat, shpeditëri është në pamundësi të sigurojë sqarimet e nevojshme, kurse rasti nuk pret për prolongim, është i obliguar të veprojë si një "shtëpiak i mirë" (ekonomist i mirë), duke i mbrojtur interesat e urdhërdhënësit ashtu që t'a njoftojë sa më parë për keto veprime.

Neni 11.

Urdhërdhënësi i bartë të gjitha pasojat që janë shkaktuar për shkak të dispozitës së gabuar, jo të plotë, të paqartë, kundërthënëse ose të dhënë me vonesë.

Neni 12.

Urdhërdhënësi me kohë duhet t'i dorëzojë shpeditërit të gjitha dokumentet e nevojshme për kryerjen e urdhërporosisë (dispozitës).

Konsiderohet se urdhërdhënësi nuk ia ka dorëzuar me kohë shpeditërit dokumentet e nevojshme edhe në rastet kur partneri i tij afarist nuk ia ka dorëzuar shpeditërit dokumentet e tilla.

Shpeditëri nuk përgjigjet për parregullsitë e fshehura të dokumentacionit.

Të gjitha pasojat që rrjedhin për shkak të parregullsive në dokumentacion apo dorëzimit jo me kohë të tyre te shpeditëri, i bartë urdhërdhënësi.

Shpeditëri nuk është i obliguar që të dorëzojë apo të pranojë gjësende (mall) duke dhënë garancion.

Neni 13.

Shpediteri i cili e kryen (realizon punët sipas) urdhërporosinë (dispozitën), nga aspekti i arkëtimit të kërkesave të urdhërdhënësit nga pranuesi i mallit, nuk është i obliguar të verifikojë bazueshmërinë e urdhërporosisë e as nuk merr obligim garantimi.

Nëse pranuesi refuzon t'i pranojë gjësendet, shpediteri është i obliguar që për këtë ta njoftojë urdhërdhënësin dhe njëkohësisht t'i merr masat e nevojshme për ruajtjen e tyre deri në pranimin e urdhërporosisë tjetër.

Urdhërdhënësi do t'i paguajë shpeditërit, për punët sipas pikave paraprake, kompenzim të veçantë për shërbimet, si dhe t'i kompenzojë të gjitha shpenzimet që i ka pasur lidhur me arkëtimin e kërkesave të urdhërdhënësit nga pranuesi.

Neni 14.

Kur urdhërdhënësi ndryshon dispozitën (urdhërporosinë), kryerja (realizimi) e së cilës veç ka filluar, shpediteri do të veprojë sipas dispozitës së ndryshuar nëse kjo është e mundshme, pa qenë përgjegjës për pasojat e shkaktuara me ndryshimin e dispozitës.

Neni 15.

Kur urdhërdhënësi e terhjek urdhërporosinë e dhënë, është i obliguar që t'i paguajë shpeditërit kompenzim për shërbimet e kryera si dhe kompenzimin për shpenzimet e shkaktuara.

IV. PRANIMI DHE DORËZIMI I GJËSENDEVE

Neni 16.

Konsiderohet se shpediteri i ka pranuar gjësendet, kur të njëjtat i ka marrë për qëllim të dërgimit (transportimit).

Konsiderohet se me dorëzimin e gjësendeve transportuesit, është kryer dorëzimi i tyre.

Nëse nuk është kontraktuar ndryshe, shpediteri mundet që vet t'a kryej transportin, në terësi apo pjesërisht.

Nëse shpediteri e kryen vet transportin, i ka të drejtat dhe obligimet e transportuesit.

Neni 17.

Shpediteri është i obliguar t'a njoftojë urdhërdhënësin mbi fazat kryesore të transportimit të gjësendeve të tij.

Neni 18.

Nëse urdhërdhënësi ka lidhë kontratë për transport detar të gjësendeve, është i obliguar që t'i kontrakttojë edhe kushtet e zakonshme të shkarkim-ngarkimit në portet përkatëse.

Urdhërdhënësi i bartë shpenzimet e shkaktuara për shkak të dështimit të anijetarit apo organizatës portuale në përmbushjen e kushteve të zakonshme të shkarkim-ngarkimit në port.

Urdhërdhënësi i bartë shpenzimet të cilat paraqiten për shkak të bllokimit të portit, limanit, stacioneve grumbulluese apo shpërndarëse dhe punkteve të tjera të komunikacionit, mungesës së hapësirës magazinuese, mungesës së mjeteve transportuese, pritjes së anijës në port apo mjeteve të tjera transportuese në limane dhe stacione hekurudhore, punës së vazhduar pas orarit, pritjet gjatë ditëve të diela apo festive dhe ndërprerjës së punës për shkak të motit të keq.

Neni 19.

Shpediteri nuk përgjigjet (nuk jep llogari) për njoftimin e anijetarit apo agjentit të tij nga aspekti i lëvizjes apo arritjes së anijes, si dhe për njoftimin e transportuesve të tjerë.

Shpediteri është i detyruar që t'i kontrollojë të dhënat në lidhje me punën e anijes, posaqërisht të dhënat nga aspekti i kalkulimit të kohës së shpenzuar në rastet e qëndrimit (demurrage) apo tejqëndrimit (mos ngarkimit-shkarkimit me kohë), dhe përgjigjet (jep llogari) për keto të dhëna.

Neni 20.

Ditët e humbura (për shkak të tejqëndrimit) të mjeteve transportuese për dërgesat në të cilat në bazë të dokumentacionit transportues shpediteri figuron si pranues, e të cilat nuk janë shkaktuar me faj të argumentuar të shpeditarit, i bartë urdhërdhënësi me të drejtë rimbursimi nga organizata e cila e ka fshehë tejqëndrimin.

V. DOKUMENTET TRANSPORTUESE DHE PËRCJELLËSE

Neni 21.

Nga aspekti i dokumenteve të nevojshme për transportimin e gjësendeve shpediteri mund të shërbehet me dokumente (formularë) “tipikë”, të cilët janë të zakonshëm në degë përkatëse transportuese. Në qoftë se, në këto dokumente ekzistojnë klauzola me të cilat zvogëlohet apo përjashtohet përgjegjësia e transportuesve, shpediteri nuk jep llogari (nuk pergjigjet) për ato klauzola.

Kur urdhërdhënësi dëshiron që t’i përjashtojë disa klauzola në dokumentet e zakonshme transportuese, ai në mënyrë eksplicite, me shkrim dhe në kohë të duhur do t’a njoftojë shpediterin.

Shpediteri është i obliguar që t’a paralajmërojë urdhërdhënësin kur për shkak të përjashtimit apo shtimit të klauzolave në dokumentet transportuese, qartë vërehet se mund të shkaktohen pasoja të dëmshme për të.

Neni 22.

Shpediteri nuk e verifikon vlefshmërinë e autorizimit-kompetencave të prurësit të dokumenteve përcjellëse si dhe të nënshkruesit të dispozitës.

Shpediteri, gjithashtu, me pranimin e dispozitës, nuk shqyrton-verifikon se a ekzistojnë pengesa ligjore apo të tjera për dërgimin (transportimin) e gjësendeve, se a ekzistojnë kufizime importuese, eksportuese apo tranzitore dhe të tilla të ngjajshme. Shpenzimet eventuale të shkaktuara në lidhje me këtë, e ngarkojnë urdhërdhënësin.

VI. ARRITJA E DËRGESËS SË DËMTUAR DHE PROCEDURA

Neni 23.

Kur dërgesa mbërrinë në destinacion, me dëmtime të dukshme apo me mungesë koletare të dukshme, shpediteri, në qoftë se në atë vend e perfaqëson pranuesin, është i obliguar që pa vonesë t’a njoftojë urdhërdhënësin mbi dëmtimin e mallit dhe për të gjitha ndodhitë që janë me rëndësi për urdhërdhënësin, si dhe t’i marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e të drejtave të urdhërdhënësit ndaj personit përgjegjës.

Neni 24.

Nëse shpediteri konsideron se është në interes të urdhërdhënësit të ndërmerren disa punë të caktuara, kurse nuk mundet që paraprakisht t'i merr udhëzimet e tij, është i autorizuar t'i kryej ato punë për llogari dhe rrezik të urdhërdhënësit.

Në rastet kur, në një vend ringarkimi shpediteri përfaqëson edhe dërguesin edhe pranuesin është i obliguar që me kujdesin e ekonomistit të mirë t'i mbrojë interesat e të dy palëve dhe t'i njoftojë ata mbi punën që kryen.

Neni 25.

Shpediteri është i obliguar, në rast të avarisë gjenerale, t'a njoftojë urdhërdhënësin mbi faktet për të cilat është njoftuar.

VII. INSTRADIMI

Neni 26.

Kur dispozita nuk përmban urdhërporosi mbi rrugën transportuese, mjetin transportues dhe mënyrën në të cilën duhet të transportohen gjësendet, shpediteri është i autorizuar të zgjedh respektivisht kombinojë elemente të cilat do të jenë më të favorshme për urdhërdhënësin.

Neni 27.

Kur gjësendet dërgohen me hekurudhë kurse urdhërdhënësi ka përcaktuar vetëm vendbanimin e pranuesit pa shënuar stacionin hekurudhor me numër referues, shpediteri, në qoftë se nuk është në mundësi që me kohë t'i sigurojë sqarimet e nevojshme nga urdhërdhënësi, dërgesen do t'a drejtojë në atë stacion i cili është më i favorshëm për urdhërdhënësin.

Në këtë rast shpediteri nuk përgjigjet për zgjedhjen e stacionit.

Neni 28.

Shpediteri mund t'i dergojë dërgesat parcialesh me anë të transportit përmbledhës, përderisa nuk ka pranuar urdhërporosi tjetër në mënyrë të qartë dhe me shkrim.

Mbi marrjen dhe dërgimin e mallit, shpediteri është i obliguar që, nëse urdhërdhënësi ashtu kërkon, t'i leshojë vërtetimin e zakonshëm shpediter.

Shpediteri e ka të drejtën e përfitimit nga dallimi i shpenzimeve transportuese të realizuar me transport përmbledhës, mirëpo në këtë rast nuk ka të drejtë për ndonjë komision të veçantë shtesë.

Neni 29.

Urdhërdhënësi, në kontratën shitëse, në përputhje me paritetin (kushtet tregtare) nga ajo kontratë, do t'a obligojë partnerin e vet, që nga pikëpamja e transportit të gjësendeve, t'i përmbahet udhëzimeve të cilat do t'i jap shpediteri.

Shpediteri nuk përgjigjet për dëmin, nëqoftëse partneri i urdhërdhënësit nuk i është përmbajtur udhëzimeve të tij.

VIII. AFATET

Neni 30.

Shpediteri përgjigjet për afatin e dërgimit apo të dorëzimit, vetëm nëse për këtë posaqërisht është obliguar, por edhe atëherë vetëm në kufijtë e përgjegjësisë së transportuesit dhe pjesëmarrësve të tjerë në transportin e mallit, të cilët i ka angazhuar shpediteri.

Neni 31.

Shpediteri është i obliguar që në vendin e ringarkimit të gjësendeve, të jetë i ndërgjegjshëm dhe i kujdesshëm në veprimet e tij, ashtu që ringarkimi të kryhet në mënyren më të favorshme.

Shpediteri nuk përgjigjet për pengesat apo vonesat gjatë ringarkimit të gjësendeve, të shkaktuara nga lëshimet e transportuesit, organizatave ringarkuese apo të tjera, si dhe nga fuqia madhore.

Shpediteri nuk përgjigjet për vendosjen jo me kohë në dispozicion të mjetit transportues nga ana e transportuesit, si dhe për arritjen jo me kohë të gjësendeve për shkak të ngecjeve në komunikacion apo pengesave të tjera.

IX. SHIQIMI (VERIFIKIMI) I PAKETIMIT

Neni 32.

Urdhërdhënësi respektivisht partneri i tij, është i obliguar që gjësendet t'i paketojë sipas natyrës së tyre, tipareve si dhe të nevojave të rrugëve transportuese dhe të mjetit transportues.

Shpediteri nuk përgjigjet për pasojat që dalin për shkak se urdhërdhënësi respektivisht partneri i tij, nuk i përmbahen dispozitave nga kontrata.

Nëse shpediteri vëren se gjësendet nuk janë të paketuara apo nuk janë të përgaditura për transport ashtu siq duhet, shpediteri është i obliguar t'a paralajmërojë urdhërdhënësin për këto mungesa.

Në rastet kur pritja derisa urdhërdhënësi t'i menjanojë këto, është me dëm për urdhërdhënësin, shpediteri është i obliguar t'i menjanojë këto mungesa për llogari të urdhërdhënësit.

X. KONSTATIMI I SASISË

Neni 33.

Nëse nuk është kontraktuar ndryshe, shpediteri i pranon gjësendet në copë vetëm në bazë të copave, kurse gjësendet e shkapërderdhura, sipas deklarimit të urdhërdhënësit apo në bazë të dokumenteve transportuese, pa marrë përgjegjesi për peshën, përmbajtjen, respektivisht natyrën e mallit.

Peshimi, matja dhe numërimi i gjësendeve dhe koletave kryhet vetëm në bazë të urdhërporosisë, në rastet e dëmtimit të dukshëm apo mungesës së mallit, duke arkëtuar shpenzimet dhe kompenzimin shtesë.

Shpediteri mund t'i peshojë gjësendet edhe me anë të organizatës e cila merret me atë punë.

XI. MARRJA E MOSTRAVE

Neni 34.

Shpediteri i nxjerr (merr) dhe i dërgon mostrat në bazë të dispozitës së urdhërdhënësit. Shpenzimet e nxjerrjes, dërgimit dhe të kompenzimit shtesë i bartë urdhërdhënësi.

Shpediteri është përgjegjës vetëm për nxjerrjen (marrjen) e mostrave nga tërësia e gjësendeve të cilat janë shenjuar nga urdhërdhënësi.

XII. DOGANIMI

Neni 35.

Konsiderohet se, me dhënjen e urdhërporosisë (dispozitës) për dërgimin (transportin, bartjen) e mallërave është dhënë edhe urdhërporosia (autorizimi) për doganim përveç nëse nuk është kontraktuar ndryshe, në mënyrë të qartë dhe me shkrim.

Në procedurën e doganimit të gjësendeve, shpediteri paraqitet në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit.

Shpediteri i parashtron dokumentet doganore në bazë të të dhënave të urdhërdhënësit, respektivisht partnerit të tij. Shpediteri nuk bartë përgjegjësi nëse të dhënat nuk përputhen me gjëndjen faktike. Urdhërdhënësi është i obliguar që t'i kompenzojë shpediterit dëmin e shkaktuar nga kjo.

Për kryerjen e punëve të përfaqësuesit doganor, shpediterit i takon kompenzim i veçantë.

Urdhërporosia për doganim të gjësendeve nuk përmban edhe obligimin që shpediteri t'i paguajë taksat (tarifat) doganore për llogari të urdhërdhënësit.

Shpediteri e zgjedh vendin e doganimit në rastet kur kjo, me dispozitë respektivisht rregullativë nuk është përcaktuar.

XIII. SIGURIMI

Neni 36.

Shpediteri i siguron gjësendet në bazë të dispozitës eksplicite në lidhje me secilën dërgesë në mënyrë të veçantë. Shënimi mbi vlerën në dispozitë, vetëm si i tillë, nuk është i mjaftueshëm që të konsiderohet si urdhërporosi për sigurim. Gjithashtu, me sigurimin e një dërgese nuk lind obligimi i shpediterit që të i sigurojë të gjitha dërgesat e ardhshme të urdhërdhënësit.

Kur urdhërporosia për sigurim nuk përmban rreziqet e veçanta të cilat duhet të mbulohen me sigurim, shpediteri është i obliguar që t'i mbulojë vetëm rreziqet bazike transportuese.

Nëqoftëse urdhërdhënësi nuk e ka dhënë urdhërporosinë për sigurim, ose e ka dhënë urdhërporosinë për sigurim të pjesëshem, pasojat e dëmshme që mund të lindin bien mbi barrë të urdhërdhënësit.

XIV. KOMPENZIMI PËR SHËRBIME DHE KOMPENZIMI PËR SHPENZIME

Neni 37.

Shpediteri ka të drejtë për kompensim të shërbimeve të veta, si dhe kompensim të shpenzimeve të veta.

Kompensimi përcaktohet me çmimore (tarifë) apo me kontratë të veçantë.

Urdhërdhënësi mbetet obligues ndaj shpediterit edhe atëherë kur e udhëzon që kompensimet e veta t'i arketojë nga personat e tretë.

Shpediteri, për shërbimet e veta të kryera për llogari të urdhërdhënësit nga jashtë shtetit, ka të drejtë në kompensim të shërbimeve të veta dhe kompensim të shpenzimeve të veta, në valutën e vendit në të cilën urdhërdhënësi e ka selinë, apo, në bazë të marrëveshjes, në cilindo valutë.

Kur shpediteri (i thirrur para vjetërsimit të lëndës) ka arkëtuar më pak për shpenzimet transportuese, të tarifave doganore, të magazinimit, tejqëndrimit dhe të tilla të ngajshme,

urdhërdhënësi është i obliguar, nëse këto shpenzime nuk kanë qenë të përfshira nën një shumë të përgjithshme (pozicion forfait), që t'i kompenzojë shumat e paguara.

Ndalesat dhe masat tjera, nuk ndikojnë në të drejtën e shpeditërit ndaj urdhërdhënësit, dhe edhe në këto raste, të gjitha të drejtat e tij për kompenzim mbesin të paprekura.

Fatura e shpeditërit duhet të paguhet në afat prej 8 ditëve pas pranimit, nëse nuk është përcaktuar ndryshe. Kundërshtimet ndaj faturës duhet të bëhen gjatë afatit të njëjtë.

Kur me kundërshtim kontestohet një pjesë e faturës, pjesa jo kontestuese duhet të paguhet në afat prej 8 ditëve.

Kur shpeditëri gjatë realizimit të urdhërporosisë angazhon mjete të veta monetare, ka të drejtë në komision (provizion) të veçantë për paranë e gatshme të dhënë, lartësia e të cilit përcaktohet me tarifë, respektivisht marrëveshjes me urdhërdhënësin.

XV. PËRGJEGJËSIA E SHPEDITERIT

Neni 38.

Shpeditëri është i obliguar që në çdo situatë të veprojë ashtu si e kërkojnë interesat e urdhërdhënësit dhe me kujdesin e ekonomistit të mirë (shtëpiakut të mirë).

Kur me kontratë mbi shpeditimin përcaktohet një shumë e përgjithshme (pozicion forfait i kompletuar për të gjitha fazat e shpeditimit respektivisht transportit) për kryerjen gjithëpërfshirëse të urdhërporosisë për shpeditimin e gjësëndeve, ajo përfshinë gjithë kompenzimin për të gjitha shërbimet respektivisht kompenzimin për dërgim, kompenzimin për transport, si dhe kompenzimin për të gjitha shpenzimet tjera.

Në rastet sipas paragrafit paraprak (punët forfait) shpeditëri përgjigjet edhe për punën e transportuesit, si dhe të dhënësve të tjerë të shërbimeve, shërbimet e të cilëve kanë qenë të përfshira në shumën e përgjithshme, të paraqitura në paragrafin dy të këtij neni.

Në rastet tjera shpeditëri përgjigjet për zgjedhjen e transportuesit, si dhe për zgjedhjen e personave të tjerë me të cilët në kryerjen e urdhërporosisë ka lidhur kontratë (p.sh. magazinimi i mallit e të ngjajshme...) mirëpo nuk përgjigjet për punën e tyre, përjashtimisht nëse përgjegjësinë e ka marrë me kontratë. Në këto raste shpeditëri është i obliguar që t'i ndërmerrë të gjitha masat ashtu që të sigurohen të drejtat e urdhërdhënësit për kompenzim të dëmit.

Shpediteri i cili kryerjen gjithëpërfshirëse të urdhërporosisë ia beson shpediterit tjetër, në vend se t'a kryej vet, përgjigjet për punën e tij.

Nëse shpediteri kryen vet edhe punë të tjera të përfshira në urdhërporosi, sipas zakoneve apo kushteve të përgjithshme i ka të drejtat dhe obligimet që dalin nga ato lloje të punëve.

Nëse urdhërporosia përmban autorizim eksplicit apo të heshtur (të nënkuptueshëm) për shpediterin, që kryerjen e urdhërporosisë t'ia besojë shpediterit tjetër apo nëse është e qartë se është në interes të urdhërdhënësit, shpediteri përgjigjet vetëm për përzgjedhjen e tij, përveç nëse e ka marë (pranuar) përgjegjësinë për punën e tij (të shpediterit tjetër).

Shpediteri përgjigjet për numrin e copave, si dhe për shënjimimin e koletave, përderisa janë të dukshme respektivisht shifen me sy (në rastet kur ai është përgjegjës për bartjen e gjësendeve). Shpediteri nuk përgjigjet për peshën, vullumin (kubaturën), kualitetin, përmbajtjen apo vlerën e gjësendeve.

Konsiderohet se shërbimi i shpediterit është kryer drejtë, nëse dërgesa është dërguar më tutje në atë gjendje në të cilën edhe është pranuar.

Shpediteri nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga forca madhore apo nga vetitë e vet gjësendeve.

Shpediteri nuk përgjigjet për kalkulime jo të sakta të shpenzimeve transportuese, si dhe të taksave doganore apo taksave të tjera publike. Ai është i obliguar që të parashtrojë ankesë (reklamacion) vetëm nëse urdhërdhënësi në mënyrë eksplicite këtë e kërkon. Në këtë rast urdhërdhënësi është i obliguar që t'i dorëzojë shpediterit dokumentet transportuese, doganore dhe të tjera dokumente të nevojshme për parashtrimin e ankesës (reklamacionit). Shpediteri është i obliguar që t'ia përcjellë urdhërdhënësit dokumentet në afat prej 3 ditëve pas pranimit të tyre.

Shpediteri mundet, nëse kjo objektivisht është e mundshme, me kërkesë të urdhërdhënësit, me shpenzim, për llogari si dhe për rrezik të tij, të parashtrojë kërkesë zhdëmtuese dhe të udhëheqë kontestin kundër personave me të cilët ka lidhë kontratë gjatë kryerjes së urdhërporosisë për shpeditimin e gjësendeve.

XVI. PENGU DHE MBAJTJA E PENGUT

Neni 39.

Me qëllim të sigurimit të arkëtimit të kërkesave të veta nga urdhërdhënësi, që dalin nga kontrata mbi shpeditimin, shpediteri e ka të drejtën e "pengut" dhe "mbajtjes", mbi gjësendet të cilat janë dorëzuar me qëllim të dërgimit apo sjelljes (bartjes) apo me punët që lidhen me dërgimin apo sjelljen e gjësendeve (bartjes), deri sa urdhërdhënësi nuk i paguan kërkesat e tij.

Neni 40.

Me qëllim të sigurimit të arkëtimit të kërkesave të veta (të momentit apo më të hershme) nga urdhërdhënësi, shpediteri e ka të drejtën e pengut mbi gjësendet e urdhërdhënësit, gjithmonë përderisa disponon me gjësendet apo i ka në zotërim dokumentet me anë të së cilave mund të disponojë me gjësendet e urdhërdhënësit.

Neni 41.

Kur në dispozitën e urdhërdhënësit, gjësendet i janë vendosur në disponim personit të tretë apo duhet t'i dorëzohen personit të tretë, shpediteri mund të shërbehet me të drejtën e pengut për kërkesat ndaj personave të tretë vetëm nëse këto kërkesa kanë të bëjnë me gjësendet të cilat shpediteri i mban mbi bazen e lartëshënuar (dispozitës përkatëse).

XVII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 42.

Kushtet e përgjithshme hyjnë në fuqi ditën e publikimit në gazetën zyrtare të Odës Ekonomike të Kosovës.

SHOQATA E SHPEDITERËVE TË BRENDSHËM DHE NDËRKOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në Prishtinë,

Më 30.01.2012

